Albanian



JUSTRIGHT SCOTLAND

# NJIHNI TË DREJTAT TUAJA!

## Informacion mbi të drejtat dhe mbështetjen në Skoci për gratë e huaja të trafikuara

**A jeni njohur si viktimë e trafikimit ose e shfrytëzimit?**

Të qenit viktimë e trafikimit ose e shfrytëzimit mund të ketë një ndikim afatgjatë te ju dhe mund të ndikojë në shumë aspekte të jetës suaj. Mund të keni gjithashtu vështirësi në përshtatjen me jetesën në një shtet apo vend të ri. Por nuk jeni vetëm. Ekziston ndihmë që të filloni rikuperimin nga përvojat tuaja dhe ndihmë që të integroheni në jetën tuaj të re.

Në këtë broshurë jepet informacion për një pjesë të ndihmës në dispozicionin tuaj dhe për personat e kontaktit.

**Mund të kontaktoni "JustRight Scotland" për këshilla dhe informacion për çfarëdo çështjeje të trajtuar në këtë broshurë.**

Mund të na kontaktoni në numrin **0141 406 5350**
në adresën e emailit **info@justrightscotland.org.uk**
si dhe mund të na gjeni në adresën **www.justrightscotland.org.uk**

JUSTRIGHT SCOTLAND

**Ju mund të kontaktoni gjithashtu "JustRight Scotland" për këshilla dhe informacion për çfarëdo çështjeje të trajtuar në këtë broshurë në lidhje me trafikimin dhe/ose shfrytëzimin tuaj.**

Mund të na kontaktoni në numrin **0141 406 5350**,
në adresën e emailit **info@justrightscotland.org.uk**
si dhe mund të na gjeni në adresën **www.justrightscotland.org.uk**

Kjo broshurë është hartuar nga "JustRight Scotland" dhe gratë me përvoja të trafikimit, si pjesë e projektit të BE:

**ASSIST:** "Gender Specific Legal Assistance and Integration Support for Third Country National Female Victims of Trafficking for Sexual Exploitation" (Ndihmë ligjore specifike sipas gjinisë dhe mbështetje për integrimin e femrave të vendeve të botës së tretë viktima të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual)

Financuar nga Fondi për Azilin, Migracionin dhe Integrimin i Bashkimit Evropian

## KUSH MUND T'JU NDIHMOJË

Nëse jeni viktimë e trafikimit dhe/ose e shfrytëzimit dhe ju nevojitet ndihmë, mund të kontaktoni:

- Linjën telefonike pa pagesë "Modern Slavery Helpline": 0800 012 1700 www.modernslaveryhelpline.org/scotland
- Policinë e Skocisë: në numrin 999 për ndihmë urgjente. Nëse nuk është rast urgjent, telefononi në numrin 101.

Nëse jeni e shqetësuar se dikush tjetër mund të jetë viktimë e trafikimit, mund të kontaktoni sërish linjën telefonike pa pagesë "Modern Slavery Helpline" ose policinë e Skocisë. Po ashtu, mund të raportoni në mënyrë anonime te:

- Crimestoppers: 0800 555 111

## MBËSHTETJA E SPECIALIZUAR NË SKOCI

**Trafikimi**
Nëse jeni një femër e moshës mbi 18 vjeç dhe jeni trafikuar dhe shfrytëzuar seksualisht, mund të merrni ndihmë dhe këshillë nga:

- TARA (Trafficking Awareness Raising Alliance) – 0141 276 7724

Për të gjitha llojet e trafikimit dhe shfrytëzimit të burrave dhe grave të moshës mbi 18 vjeç OSE për burrat që janë trafikuar dhe shfrytëzuar seksualisht, mund të merrni ndihmë nga:

- "Migrant Help" (Ndihmë për Emigrantët)– 0141 884 7900

**Nëse dëshironi të raportoni në polici, mund të telefononi në numrin 101.
Në rastin e një urgjence, telefononi në numrin 999.**

**Aspekti juridik**
Nëse keni një problem me ndonjë nga pikat e përmendura në këtë broshurë, mund t'ju nevojitet këshillim juridik dhe mund të gëzoni të drejtën e përfitimit të ndihmës juridike.

**Për t'ju ndihmuar me këtë, mund të gjeni një avokat** në faqen e internetit të "Law Society of Scotland" (Shoqëria Ligjore e Skocisë):

- www.lawscot.org.uk/find-a-solicitor

**Për udhëzimet më të fundit nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (NHS) i Skocisë dhe qeveria e Skocisë, ju lutemi kontrolloni www.nhsinform.scot**

## SHËNDETI

Ju gëzoni të drejtën e kujdesit shëndetësor falas e konfidencial nga një mjek i përgjithshëm (i quajtur "mjek i kujdesit parësor"). Mund të regjistroheni duke bërë një vizitë te klinika e mjekut të përgjithshëm të zonës. Nëse preferoni, mund të kërkoni gjithashtu një mjeke ose një infermiere (femër). Mund kërkoni gjithashtu një përkthyes.

Përveç kësaj, mund të merrni shërbime në rast aksidentesh ose urgjencash në spitalet e NHS. Në varësi të llojit të lejes së qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar, mund t'ju duhet të paguani për një pjesë të trajtimit mjekësor. Këtu mund të përfshihet kujdesi dentar dhe për sytë.

**Ndihma psikologjike**
Trafikimi dhe shfrytëzimi mund të kenë një ndikim të madh në shëndetin tuaj mendor, që mund të vazhdojë për një kohë të gjatë pas përfundimit të shfrytëzimit. Ju mund të përjetoni shumë vështirësi, për shembull, mund të ndiheni shumë e trishtuar, në ankth ose e rraskapitur. Po ashtu mund të keni vështirësi me gjumin, të keni makthe, të vuani nga humbja e kujtesës ose ulja e përqendrimit.

Flisni me mjekun tuaj të përgjithshëm për ndijimet tuaja. Ai mund t'ju referojë në shërbime të specializuara psikologjike, ku mund të merrni ndihmë konfidenciale për të kuptuar dhe për të përballuar ndijimet tuaja.

Gjithashtu, mund të flisni në mënyrë konfidenciale me:

- "Trauma Counselling Line Scotland" (Linja e këshillimit në rast traumash, Skoci): 08088 020 406 www.health-in-mind.org.uk
- "Samaritans" (Samaritanët): 116 123 www.samaritans.org

## PUNËSIMI

Puna vullnetare mund t'ju ndihmojë të zhvilloni aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të filluar një punë.

Ajo mund t'ju ndihmojë gjithashtu në krijimin e vetëbesimit dhe të aftësive të rëndësishme për jetën.

Informacion rreth mundësive për punë vullnetare mund të gjeni në adresën:

- www.volunteerscotland.net

Nëse ju duhet ndihmë për të gjetur punë me pagesë, mund të kontaktoni me agjencinë "Skills Development Scotland" (Zhvillimi i Aftësive, Skoci), e cila mund t'ju mbështesë të përmirësoni dhe zhvilloni aftësitë që ju nevojiten për të punuar dhe t'ju ndihmojë me CV-tuaj.

- "Skills Development Scotland" (Zhvillimi i Aftësive, Skoci) – 0800 917 8000 www.skillsdevelopmentscotland.co.uk

Këshilli vendor mund t'ju thotë gjithashtu se cilat janë shërbimet e punësimit në zonën tuaj. Për më tepër informacion, mund të kontrolloni faqen e tyre të internetit.

Nëse jeni në kërkim të një pune, mund të gjeni punë të reklamuara në "Jobcentre" lokale ose në adresën:

- Jobcentre Plus: www.gov.uk/find-a-job
- My Job Scotland: www.myjobscotland.gov.uk

Gjithashtu, në zonën tuaj ka agjenci punësimi që mund t'ju informojnë për punët e disponueshme.

Nëse jeni refugjate, mund të merrni këshilla mbi punësimin nga:

- "Scottish Refugee Council" (Këshilli për Refugjatët i Skocisë): 0141 223 7979 www.scottishrefugeecouncil.org.uk
- "Bridges Programme" (Glasgou): 0141 558 9749 www.bridgesprogrammes.org.uk

Albanian

## SHËNDETI (vazhdim)

**Shëndeti seksual**
Ka klinika të specializuara ku mund të merrni këshilla konfidenciale dhe informacion për shëndetin seksual të grave. Ju mund të përdorni shumë shërbime, duke përfshirë kontracepsionin (përfshirë kontracepsion në rast urgjent), analizat për infeksione seksualisht të transmetueshme (STI) dhe ndihmë për problemet e riprodhimit.

**Burime të tjera të shëndetit**
Nëse klinika e mjekut tuaj të përgjithshëm është e mbyllur dhe jeni shumë e sëmurë për të pritur sa ajo të rihapet, mund telefononi "NHS 24" në numrin 111 për ndihmë dhe për të kontaktuar një "Mjek të përgjithshëm në dispozicion jashtë orarit të punës". Ky numër NUK është për urgjenca.

- Për trajtim mjekësor në rast urgjent, telefononi në numrin 999 dhe kërkoni një ambulancë.

## ARSIMI



Aksesi në kurset kualifikuese dhe financimet për arsimin varen nga lloji i lejes së qëndrimit që keni në Mbretërinë e Bashkuar. Kurset mund të variojnë nga kurse për përmirësimin e aftësive në gjuhën angleze, deri te studimet për ndjekjen e karrierës ose universitetit. Ju mund të gëzoni gjithashtu të drejtën e mbështetjes financiare si student/e. Flisni me shërbimet për studentët të kolegjit tuaj në lidhje me llojet e kurseve që mund të kryeni dhe financimet që keni të drejtë të përfitoni.

Mund t'ju nevojitet mbështetje dhe ndihmë shtesë për të përfituar sa më shumë nga arsimi. Kontaktoni me shërbimet për studentët në kolegjin ose universitetin tuaj dhe diskutoni rreth ndihmës dhe mbështetjes që është në dispozicionin tuaj.

## A JENI VIKTIMË E TRAFIKIMIT DHE/OSE E SHFRYTËZIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?

**Disa nga shenjat (ka edhe shumë të tjera):**

- Ju kanë sjellë në Mbretërinë e Bashkuar me forcë ose nëpërmjet mashtrimit
- Ju kanë detyruar të merrni pjesë në akte seksuale kundër vullnetit tuaj, për para dhe paratë i merr dikush tjetër
- Keni punuar me orar të zgjatur dhe keni pak ose asnjë ditë pushim
- Ju duhet t'i kryeni këto akte/punë për të shlyer një borxh
- Jeni nën kontrollin e dikujt tjetër
- Lëvizjet tuaja monitorohen dhe/ose kontrollohen nga të tjerë
- Transferoheni në vendndodhje të ndryshme nga persona të tjerë
- Jeni abuzuar mendërisht, fizikisht, seksualisht, ose ju kanë kërcënuar se do t'ju lëndojnë
- Ju kanë thënë të mos i tregoni askujt se çfarë po ndodh me ju
- Ju kanë marrë pasaportën ose dokumentet
- Jeni detyruar të udhëtoni me pasaportë/dokumente false ose me një identitet tjetër
- Nuk keni leje për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar dhe ju kanë thënë se do të detyroheni të largoheni nëse informoni policinë ose autoritetet lidhur me atë që po ndodh me ju
- Ju kanë thënë se do t'ju lëndojnë familjen nëse nuk veproni siç ju thonë dhe/ose nëse i tregoni ndokujt lidhur me atë që po ju ndodh
- Ju kanë detyruar të bëni një betim me të cilin premtoni se nuk do t'i tregoni askujt se çfarë po ndodh me ju..

Mund të ketë vetëm një ose asnjë nga këto shenja ose mund të përjetoni gjëra të tjera dhe prapë të jeni viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Nëse mendoni se ky është rasti juaj, **ju lutemi kërkoni ndihmë.**

## TË DREJTA DHE SHËRBIME TË TJERA



**Kompensimi për lëndimet nga veprimtaritë kriminale**
Ju gëzoni të drejtën e kompensimit financiar për lëndime (fizike dhe/ose mendore) të pësuara gjatë kohës së trafikimit/shfrytëzimit tuaj në Mbretërinë e Bashkuar.

Mund të aplikoni pranë "Criminal Injuries Compensation Authority" (Autoriteti për Kompensimin për Lëndime nga Veprimtaritë Kriminale) (CICA) për kompensim financiar për lëndimet që keni pësuar gjatë kohës që jeni trafikuar/shfrytëzuar në Mbretërinë e Bashkuar. CICA është një fond qeveritar për viktimat e krimit të dhunshëm.

Informacion të mëtejshëm mbi kompensimin për lëndimet nga veprimtaritë kriminale mund të gjeni në:

- "Criminal Injuries Compensation Authority" (Autoriteti për Kompensimin për Lëndime nga Veprimtaritë Kriminale) – 0300 003 3601
www.gov.uk/claim-compensation-criminal-injury

**Kompensime të tjera**
Ju mund të ngrini gjithashtu një padi kundër personave që ju trafikuan/shfrytëzuan. Për këtë mund t'ju ndihmojë një avokat.

**Ligji për punësimin**
Mund të ngrini një padi kundër një punëdhënësi në rast të shfrytëzimit prej tij (p.sh. rroga të papaguara; kushte të këqija pune; diskriminim). Për këtë mund t'ju ndihmojë një avokat.



**Bashkimi familjar**
Nëse keni marrë statusin e refugjatit(es) ose të ndihmës humanitare në Mbretërinë e Bashkuar, ju gëzoni të drejtën të sillni bashkëshortin/partnerin dhe fëmijë nën moshën 18 vjeç që jetojnë jashtë vendit për t'u bashkuar me ju në Mbretërinë e Bashkuar. Për këtë mund t'ju ndihmojë një avokat.



**Statusi i imigracionit**
Mund të nevojitet që të rishikoni statusin tuaj të imigracionit ose të merrni këshilla për kushtet e lejes suaj të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar. Për këtë mund t'ju ndihmojë një avokat.

**Përdhunimi dhe sulmi seksual/Dhuna në familje**
Nëse po përjetoni ose keni përjetuar dhunë dhe/ose abuzim (fizik, psikologjik ose emocional), mund të flisni në mënyrë konfidenciale dhe të merrni këshilla nga:

- "Scottish Women's Aid" (Ndihmë për Gratë në Skoci):
0800 027 1234
www.womensaid.scot
- "Rape Crisis Scotland" (Kriza nga përdhunimi, Skoci):
0808 801 0302
www.rapecrisisscotland.org.uk
- "Scottish Women's Rights Centre"
(Qendra për të Drejtat e Grave në Skoci):
www.scottishwomensrightscentre.org.uk

**Përfshirja në industrinë e seksit**
Nëse jeni e përfshirë në industrinë e seksit dhe ju nevojitet ndihmë dhe këshillim, mund të gjeni shërbime të disponueshme në:

- "Encompass"
www.encompassnetwork.info



## STREHIMI

Ju gëzoni të drejtën e strehimit të mbrojtur dhe të sigurt. Nëse keni marrë banesë sociale me qira nga këshilli vendor(bashkia) ose nga shoqata e strehimit, flisni me punonjësin e strehimit për çdo problem që keni me strehimin tuaj. Për shembull:



- Riparime
- Përdorimi i pajisjeve shtëpiake
- Mobilimi i banesës
- Sjellje antisociale
- Vonesa në kryerjen e pagesës së qirasë

Ju mund të merrni gjithashtu këshillë të pavarur dhe ndihmë nga:

- "Citizens Advice Bureau" (Zyra Vendore për Këshillimin e Qytetarëve) (CAB)
www.citizensadvice.org.uk/scotland
- "Shelter Scotland" (Strehim në Skoci): 0808 800 4444:
www.scotland.shelter.org.uk

Nëse keni marrë një banesë me qira privatisht, duhet të kontaktoni për këshilla CAB ose "Shelter Scotland" (Strehim në Skoci).

## PËRFITIMET E NDIHMËS SOCIALE DHE PARAVE

Në varësi të rrethanave tuaja, ju mund të gëzoni të drejtën të merrni ndihma financiare të ndryshme, por nuk jeni në dijeni për këtë. Ose mund të keni probleme me ndihmat tuaja financiare. Po ashtu, mund t'ju nevojitet ndihmë në menaxhimin e parave tuaja, shlyerjen e faturave ose ju nevojiten para për raste urgjente. Për këshilla dhe informacione për ndihmat sociale ose ndihmë me financat tuaja, kontaktoni:

- "Citizens Advice Bureau" (Zyra Vendore për Këshillimin e Qytetarëve) (CAB)
www.citizensadvice.org.uk/scotland

Nëse keni probleme me borxhe, ju mund të kontaktoni gjithashtu:

- "National Debtline" (Linja Kombëtare për Borxhet): 0808 808 4000